

**LIGJ**  
**Nr.9975, datë 28.7.2008**  
**PËR TAKSAT KOMBËTARE**  
**I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**VENDOSI:**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Ky ligj përcakton llojet e taksave dhe tarifave kombëtare që zbatohen në Republikën e Shqipërisë, nivelin e taksave kombëtare, procedurat e llogaritjes, të arkëtimit dhe transferimit në Buxhetin e Shtetit ose në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore të taksave dhe tarifave kombëtare, si dhe detyrimet që kanë agjentët e taksave dhe tarifave kombëtare. (Ndryshuar me Ligj Nr. 86/2014, date 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014)

**Neni 2**

**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Taksapagues” është çdo individ, person fizik ose juridik, vendas apo i huaj, i cili është i detyruar të paguajë njëren nga taksat kombëtare, të përcaktuara në këtë ligj.
2. “Taksë” është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit që paguhet nga çdo person apo nëpërmjet një agjenti që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim public në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. “Tarifë” është një pagesë, që një individ, person fizik apo juridik, bën drejtpërdrejt apo nëpërmjet një agjenti tek administrata tatimore qendrore. Pagesa bëhet në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mire publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë.
4. “Agjent i taksave dhe tarifave” është personi i cili, sipas kërkesave të këtij ligji, është përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e drejtorive rajonale tatimore, për t’u transferuar, më pas, në Buxhetin e Shtetit, të të ardhurave nga taksat dhe tarifat kombëtare. (Ndryshuar me Ligj Nr. 86/2014, date 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014)
5. Automjet luksoz” konsiderohet autovetura deri në 6+1, e cila plotëson të paktën njërin nga kushtet e mëposhtme:
  - a) cilindratën të barabartë ose më të madhe se 3000 cm<sup>3</sup>; ose
  - b) vlerën/çmimin të barabartë ose më shumë se 5 000 000 lekë

Vlera e mjetit plotësohet në sistemin informatik të DPTSHRR-së, kur mjeti regjistrohet për herë të parë ose/dhe sa herë ndryshon pronësia e tij. Vlera e mjetit, për efekt të klasifikimit “Automjet luksoz”, reduktohet çdo vit me 10 për qind të vlerës së mbetur.

Për automjetet të cilat shiten, vlera e shitjes së tyre, për efekt klasifikimi si “Automjet luksoz”, nuk mund të jetë më e vogël se vlera e mjetit të amortizuar, sipas paragrafit të mësipërm

(Ndryshuar me Ligj Nr.141/2015, datë 17.12.2015. Botuar në Fletoren zyrtare nr.252, datë 22.01.2016.)

(Ndryshuar me Ligj Nr.127/2016, date 15.12.2016. Botuar në Fletoren zyrtare nr. 250 datë 27.12.2016)

(Ndryshuar me Ligj Nr.104/2017, datë 30.11.2017. Botuar në Fletoren zyrtare nr.222, datë 19.12.2017)

(Shtuar me Ligj Nr.86/2019, datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren zyrtare nr.184, datë 31.12.2019)

### Neni 3

#### Llojet e taksave kombëtare

Taksat kombëtare janë:

1. Taksa portuale.

**2. Taksa e qarkullimit për benzinën (sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 12 41; 2710 12 45; 2710 12 49; 2710 12 51; 2710 12 59) dhe për gazoilin (sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47; 2710 19 48), si dhe për benzinën ose gazoilin që gjendet në përmbajtjen e biokarburantit (sipas kodeve tarifore të NKM-së 27102011 deri në kodin 27102019, 27102090, si dhe klasifikimin në nënkreun 38 26 00).**

3. Taksa e mjeteve të përdorura të transportit.

4. Taksa e rentës minerare.

5. Taksa e akteve dhe e pullës.

**6. Taksa e karbonit për benzinën (sipas kodeve të NKM-së 2710 12 41; 2710 12 45; 2710 12 49; 2710 12 51; 2710 12 59), për gazoilin (sipas kodeve të NKM-së 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47; 2710 19 48), për qymyrin (sipas kërreëve të NKM-së 2701; 2702), për vajgurin (sipas kodeve tarifore të NKM-së 27 10 19 11 deri në 27 10 19 29), për solarin (sipas kodeve të NKM-së 2710 19 62 deri në 2710 19 68), për mazutin (sipas kodeve të NKM-së 2710 19 62 deri në 2710 19 68) dhe për koks nafte (sipas kodeve të NKM-së 2713 11 00; 2713 12 00), si dhe për benzinën ose gazoilin që gjendet në përmbajtjen e biokarburantit (sipas kodeve tarifore të NKM-së 27102011 deri në kodin 27102019, 27102090, si dhe klasifikimin në nënkreun 38 26 00).**

(Ndryshuar me Ligj Nr. 157/2014, datë 27.11.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 195, datë 24 dhjetor 2014.)

7. Taksa e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit.

8. Taksa e materialeve/artikujve plastikë dhe e ambalazheve prej plastike/qelqi.

8/1. Materiale/artikuj plastikë konsiderohen mallrat e importuara sipas kapitullit 39 të NKM-së.

8/2. Ambalazh plastik/qelqi është çdo material paketues, që shërben për paketimin e produkteve, i cili mund ta mbulojë tërësisht ose pjesërisht atë, me qëllim mbrojtjen e produktit nga ndotja, infeksionet, nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe që e bëjnë të përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim. Një ambalazh mund të përmbajë disa njësi ose tipa ambalazhesh. .

9. Taksa mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror në përdorim. (Ndryshuar me Ligj Nr. 86/2014, date 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014)

**9. Taksa mbi primet e shkruara, me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil.**

10. Taksë regjistrimi fillestar dhe taksë e përvitshme për automjetet luksoze.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 178/2013, dt 28.12.2013. Botuar ne FL.Z. Nr. 203, dt. 30.12.2013.)

**(Ndryshuar me Ligj Nr. 157/2014, datë 27.11.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 195, datë 24 dhjetor 2014.)**

(Ndryshuar me Ligj Nr.141/2015, datë 17.12.2015. Botuar në Fletoren zyrtare nr.252, datë 22.01.2016.)

**(Ndryshuar me Ligj Nr.127/2016, date 15.12.2016. Botuar në Fletoren zyrtare nr. 250 datë 27.12.2016)**

(Ndryshuar me Ligj Nr.93/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 28.12.2018)

#### **Neni 4\***

##### **Niveli i taksave kombëtare**

1. Taksa portuale është 1 euro. Kjo takse paguhet, për çdo prekje, për të gjitha anijet që prekin portet dhe radat e Republikës së Shqipërisë e që kryejnë veprime tregtare.

**2. Taksa e qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin caktohet në masën 27 lekë/litër për benzinën dhe 27 lekë/litër për gazoilin. Kjo taksë paguhet për sasinë e benzinës dhe të gazoilit të importuar apo të prodhuar në vend, me përjashtim të sasisë së benzinës dhe të gazoilit të prodhuar në vend, por të eksportuar jashtë territorit të Shqipërisë.**

**(Ndryshuar me Ligj Nr. 157/2014, datë 27.11.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 195, datë 24 dhjetor 2014.)**

**(Ndryshuar me Ligj Nr.127/2016, date 15.12.2016. Botuar në Fletoren zyrtare nr. 250 datë 27.12.2016)**

3. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është e vlefshme për 365 ditë dhe caktohet sipas formulës: Cilindrata në cm<sup>3</sup> x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit. Taksa fikse për llojin e karburantit është 12,5 lekë për naftën dhe 10 lekë për benzinën. Koeficienti sipas vjetërsisë së mjetit është si në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. **Kontrolli teknik i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre kryhet brenda periudhës së vlefshmërisë 365-ditore të taksës vjetore të mjeteve të përdorura.**

**(Ndryshuar me Ligj Nr.127/2016, date 15.12.2016. Botuar në Fletoren zyrtare nr. 250 datë 27.12.2016).**

Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 25 për qind për çdo vit sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. 25 për qind e të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalojnë buxhetit të

qeverisjes vendore. Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësive të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 120/2013, date 18.04.2013. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 67, date 3.05.2013)

(Zëvendësuar me Ligj Nr.86/2019, datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren zyrtare nr.184, datë 31.12.2019)

**4. Taksa e rentës minerare caktohet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Përqindja e rentës minerare për përmbajtjen e mineralit metalor në nënproduktin minerar është në masën sa 3/7 e normës së rentës për vitin 2019, 3/8 e normës së rentës për vitin 2020 në masën 0% për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij ligji deri në fund të vitit 2023 dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2024 e në vijim së përcaktuar në shtojcën nr. 2, “Grupi i parë (I) Mineralet metalike” që i bashkëlidhet këtij ligji.**

Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka e territorit të Republikës së Shqipërisë. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare **5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore.**

**Në rastin kur taksa e rentës minerare aplikohet në përqindje, kjo taksë llogaritet duke shumëzuar vlerën e shitjes së produktit (pa TVSH) me përqindjen e rentës. Kur taksa e rentës minerare aplikohet në vlerë fikse për njësi, shuma e rentës minerare llogaritet duke shumëzuar sasinë e shitjes së produktit me vlerën e rentës minerare. Në rastin e shitjes së mineralit të grupit të parë (I), “Mineralet metalike”, për përpunim brenda vendit, nga nxjerrësi te përpunuesi, përqindja e rentës aplikohet në masën sa 3/7 e normës së rentës për vitin 2019, 3/8 e normës së rentës për vitin 2020 në masën 0% për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij ligji deri në fund të vitit 2023 dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2024 e në vijim së përcaktuar në shtojcën nr. 2, mbi vlerën (çmimin) e shitjes, e cila, për efekt të përlllogaritjes së rentës minerare, nuk mund të jetë më e vogël se çmimi i shitjes për eksport të mineralit të papërpunuar.**

(Zëvendësuar me Ligj Nr. 151 / 2020, date 17.12.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 27, datë 19.02.2021)

Pagesa e rentës minerare bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës, kur janë realizuar shitjet. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit. **Masa e rentës minerare, e përcaktuar në ligjin minerar, ndryshon sipas paragrafëve të parë dhe të dytë, të pikës 4, të nenit 4, të këtij ligji.**Përcaktimi i vlerës së rentës së pasurisë minerare, për të gjitha mineralet, sipas përcaktimeve të ligjit, kryhet në përputhje me përcaktimet e bëra në shtojcën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Këshilli i Ministrave përcakton procedurat e arkëtitimit së rentës minerare dhe dokumentacionin që duhet të paraqesë i licencuari, eksportuesi, për të vërtetuar çmimin e shitjes. Në mungesë të këtij dokumentacioni, organi i ngarkuar nga ky ligj për arkëtimin e taksës së rentës minerare, bën rivlerësimin, mbështetur në metoda alternative.

Taksa e rentës minerare për hidrokarburet e nxjerra përcaktohet me ligjin “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur.

(Shtuar me Ligj Nr. 153 / 2020, date 17.12.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 8, datë 18.01.2021)

5.Taksa e akteve dhe e pullës caktohet sipas shtojcës nr. 3, e cila i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

6.Taksa e karbonit caktohet në masën 1,5 lekë për litër për benzinën, 3 lekë për litër për gazoilin, 3 lekë për kilogram për qymyrin, 3 lekë për litër për solarin, 3 lekë për litër për mazutin, 3 lekë për litër për vajgurin dhe 3 lekë për kilogram për koks nafte. Kjo taksë nuk paguhet për sasitë e benzinës dhe të gazoilit që eksportohen.

7.Taksa e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit caktohet sipas shtojcës nr.4, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

8.Taksa e materialeve/artikujve plastikë dhe e ambalazheve plastike të importuara në kapitullin 39, të NKM-së, është 35 lekë/kg, me përjashtim të lëndëve të para në forma primare, të importuara në krerët 3901 deri në 3914, të NKM-së. Në rastet kur artikujt që importohen në kapitullin 39, të NKM-së, pjesa joplastike zë më shumë se 51 për qind të masës së përgjithshme, kjo taksë zbatohet vetëm për pjesën e masës së plastikës. Përveç kapitullit 39, kjo taksë zbatohet edhe kur materiali plastik zë, të paktën, 51 për qind të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera të importuara, të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

(Shtuar me Ligj Nr.55/2019 datë 18.07.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 113, datë 01.08.2019)

8.1 Taksa e lëndëve të para në forma primare, të importuara në krerët 3901 deri në 3914, të NKM-së, dhe që përdoret për prodhimin në vend të produkteve të plastikës është ~~25 lekë/kg~~ 10 lekë/kg.

(Zëvendësuar me Ligj Nr.55/2019 datë 18.07.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 113, datë 01.08.2019)

8.2 Taksa e ambalazheve prej qelqi është 5 lekë/kg dhe zbatohet për ambalazhet prej qelqi të importuara e të prodhuara në vend. Taksa zbatohet për të gjithë artikujt prej qelqi, sipas kreut 7010 të NKM-së, në rast se ambalazhi importohet veçmas, si dhe kur materiali i qelqit zë, të paktën, 80 për qind të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera, të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

8.3 Në rastin e importit, taksa e materialeve/artikujve plastikë, lëndëve të para në forma primare për prodhimin e materialeve plastike, si dhe e ambalazheve prej plastike/qelqi llogaritet dhe mblihet nga administrata doganore në momentin e importit.

8.4 Në rastin e prodhimit brenda vendit, taksa e ambalazheve prej qelqi mblihet nga administrata tatimore, sipas afateve dhe procedurave të deklarimit në këtë ligj. Administrata tatimore monitoron dhe kontrollon lëndët e para që përdoren për prodhimin e ambalazheve të qelqit, si dhe lëndët e para në forma primare, të importuara, me qëllim prodhimin e materialeve dhe ambalazheve plastike brenda vendit.”

8.5 Për ambalazhet plastike/qelqi, lëndët e para, si dhe për materialet/artikujt prej plastike, të cilat eksportohen dhe për të cilat taksa është paguar në momentin e importit/prodhimit të tyre, administrata doganore rimbursion shumën e taksës së paguar. Rimbursimi bëhet sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

(Riformular me Ligj Nr.55/2019 datë 18.07.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 113, datë 01.08.2019)

9. Niveli i taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror në përdorim, aplikimi, llogaritja dhe pagesa e saj bëhen sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10 270, datë 22.4.2010, “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij”, të ndryshuar. (Ndryshuar me Ligj Nr. 86/2014, date 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014)

10. Taksa mbi primet e shkruara, me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil, është 10 për qind e shumës së primit.

11. Pavarësisht nga pagesa e taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbi makinat luksoze zbatohet taksë regjistrimi në masën 70 000 lekë për regjistrim të çdo makine luksoze dhe taksë e përvitshme në masën 21 000 lekë çdo vit.

Taksa e përvitshme për automjetet luksoze është e vlefshme për 365 ditë. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblihdet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Krugor, Drejtoritë Rajonale, në momentin e vjeljes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura. Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 25 për qind për çdo vit.

**(Ndryshuar me Ligj Nr. 157/2014, datë 27.11.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 195, datë 24 dhjetor 2014.)**

(Ndryshuar me Ligj Nr.141/2015, datë 17.12.2015. Botuar në Fletoren zyrtare nr.252, datë 22.01.2016.)

**(Ndryshuar me Ligj Nr.127/2016, date 15.12.2016. Botuar në Fletoren zyrtare nr. 250 datë 27.12.2016)**

(Ndryshuar me Ligj Nr. 68/2017, date 27.04.2017. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 113, date 22.05.2017).

(Ndryshuar me Ligj Nr.93/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 28.12.2018)

#### Neni 4/1

#### Deklarata për pagesën e taksave kombëtare

1. Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të nenit 4, pikat **(hiqen fjalët “pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8), (Ndryshuar me Ligj Nr.127/2016, date 15.12.2016. Botuar në Fletoren zyrtare nr. 250 datë 27.12.2016)** të këtij ligji, si dhe agentët e taksave, në rastin kur taksat mblihdhen me agentë, detyrohen:

a) të bëjnë një deklaratë për çdo muaj, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhet deklarimi;

b) të paguajnë taksat kombëtare për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës.

2. Deklarata, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, bëhet në formën dhe përmbajtjen që përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. Deklarata për pagesën e taksave kombëtare dorëzohet në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pranë drejtorisë rajonale tatimore ku është i regjistruar personi fizik/personi juridik, subjekt i deklarimit të taksës kombëtare. (Ndryshuar me Ligj Nr. 86/2014, date 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014)

## Neni 5

### Agjentët e taksave

Sipas llojit të taksave kombëtare, agjentët që ngarkohen me vjeljen e tyre janë:

a) për taksat portuale, kapiteneria e porteve, e cila i vjel këto taksa drejtpërdrejt ose nëpërmjet agjencive detare, shtetërore apo private;

b) Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të doganave në rrethe, për taksën e qarkullimit për benzinën dhe gazoilin e importuar, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degëve të saj, për benzinën dhe gazoilin e prodhuar në vend.

c) Për taksën vjetore të mjeteve të përdorura ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

ç) për taksën e rentës minerare, organet doganore e tatimore;

d) për taksën e akteve dhe të pullës, zyrat e gjendjes civile

dh) Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të doganave në rrethe, për taksën e karbonit për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koksin e naftës e importuar, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degëve të saj, për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koksin e naftës të prodhuar në vend, në bazë të sasive të prodhimit.

e) për taksën e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit ngarkohet Drejtoria e Politikave të Peshkimit dhe degët e saj në rrethe.

ë) për taksën e materialeve/artikujve plastikë dhe taksën e ambalazheve prej plastike/qelqi ngarkohen:

i) administrata doganore, në rastet e importit të materialeve/artikujve plastikë dhe ambalazheve prej plastike/qelqi;

ii) administrata tatimore, në rastet e prodhimit brenda vendit të ambalazheve prej qelqi.

i) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të saj doganore, për vjeljen e kësaj takse në import;

ii) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive të saj rajonale, për vjeljen e kësaj takse për prodhimin vendas.

Dispozitë kalimtare (Neni 5 i ligjit 83/2012)

Të gjithë tatimpaguesit, të cilët kanë paguar, pranë administratës doganore, akcizë për ambalazhet e plastikës dhe të qelqit, sipas ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, dhe janë të pajisur me autorizim si tatimpagues akcize dhe kanë magazinë tatimore, në rast të shitjes së produktit (për të cilin është paguar akcizë në import) pas datës 1 tetor 2012 nuk janë subjekt i pagesës së taksave të përcaktuara në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji. Administrata tatimore dhe ajo doganore kryejnë verifikimet rast pas rasti.

f) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive të saj rajonale, ngarkohet me mbledhjen e taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror.

**g) Shoqëritë e sigurimit të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) ngarkohen me mbledhjen e taksës mbi primet e shkruara. Për qëllime të mbledhjes së taksës, këto shoqëri e evidentojnë atë veçmas nga primi.**

gj) për taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 86/2014, date 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014)

**(Ndryshuar me Ligj Nr. 157/2014, datë 27.11.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 195, datë 24 dhjetor 2014.)**

(Ndryshuar me Ligj Nr.141/2015, datë 17.12.2015. Botuar në Fletoren zyrtare nr.252, datë 22.01.2016.)

**(Ndryshuar me Ligj Nr.127/2016, date 15.12.2016. Botuar në Fletoren zyrtare nr. 250 datë 27.12.2016).**

(Ndryshuar me Ligj Nr.93/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 28.12.2018)

### Neni 6

#### **Transferimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat kombëtare në drejtorinë rajonale tatimore dhe në llogaritë e njësive të qeverisjes vendore**

Agjentët e taksave deklarojnë dhe transferojnë të ardhurat nga taksat dhe tarifatat për llogari të drejtorisë rajonale tatimore, në përputhje me nenet 4, 4/1 dhe 11/2, të këtij ligji. Për detyrimet e patransferuara të taksave dhe tarifave, për agjentët zbatohen sanksione në përputhje me nenin 117, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. (Ndryshuar me Ligj Nr. 86/2014, date 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014).

### Neni 7

#### **Taksa që vilet nëpërmjet pullës**

Taksa kombëtare, që vilet nëpërmjet pullës, është taksa e akteve të gjendjes civile. (Ndryshuar me Ligj Nr.86/2019, datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren zyrtare nr.184, datë 31.12.2019)

### Neni 8

#### **Komisionet që përfitojnë agjentët e taksave**

1. Taksat arkëtohen nga agjentët e taksave, të përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji, dhe transferohen në llogaritë e drejtorive rajonale tatimore dhe të llogarive të njësive të qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

2. Agjentët e taksave, për shërbimin që kryejnë, përfitojnë komision, të cilin e marrin në rrugë buxhetore. Ky komision llogaritet në përqindje mbi shumat e arkëtuara të taksave që kanë transferuar në llogari të drejtorisë rajonale tatimore dhe në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore. ”. (Ndryshuar me Ligj Nr. 178/2013, dt 28.12.2013. Botuar ne FI.Z. Nr. 203, dt. 30.12.2013.)

a) për taksat portuale (kapitenerisë së porteve) 2 për qind;

b) për taksën e qarkullimit, 0 për qind.

c) për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, 5 për qind.

ç) për taksën e akteve dhe të pullës 5 për qind;



d) për taksën e rentës minerare (Royalty) 0 për qind;

dh) për taksën e karbonit, 0 për qind.

e) për taksën e materialeve/artikujve plastikë dhe ambalazheve prej plastike/qelqi, 0 për qind;

ë) për taksën mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror 0 (zero) për qind. (Ndryshuar me Ligj Nr. 86/2014, date 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014)

**f) për taksën mbi primet e shkruara, zero për qind.**

**(Ndryshuar me Ligj Nr. 157/2014, datë 27.11.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 195, datë 24 dhjetor 2014.)**

g) për taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze, pesë për qind.

(Ndryshuar me Ligj Nr.86/2019, datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren zyrtare nr.184, datë 31.12.2019)

3. Komisionet e përfituara përdoren:

a) në formën e shpërblimit mbi pagën, për vështirësi në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;

b) në formën e pagës, për rastet kur merren punonjës të rinj, për përballimin e vjeljes së taksave;

c) për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe për përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksave.

(Ndryshuar me Ligj Nr.141/2015, datë 17.12.2015. Botuar në Fletoren zyrtare nr.252, datë 22.01.2016.)

(Ndryshuar me Ligj Nr.93/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 28.12.2018)

## Neni 9

### Përrjashtimet nga pagimi i taksave kombëtare

1. Përrjashtohen nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura:

a) mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, që gëzojnë status diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit;

**b) Personat fizikë apo juridikë, të cilët deklarojnë se nuk do të qarkullojnë me mjete në pronësi të tyre gjatë vitit kalendarik, përrkohësisht vetëm një herë brenda një viti kalendarik, ose do të dalin përrfundimisht nga qarkullimi dhe që dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përrgjithshme të Shërrbimit të Transportit Rrugor, targën dhe lejen e qarkullimit, me kusht që të kenë paguar detyrime të prapambetura, nëse kanë.**

**c) pagesat e taksës së mjeteve të bllokuara me vendim të gjykatës, të prokurorisë, për periudhën në të cilën mjete ka qenë i bllokuar, dhe pagesat e taksës së mjeteve të vjedhura, të djegura, të shkatërruara nga aksidentet, të vërrtetuara nga organet e prokurorisë.**

ç) **autoveturat tip deri në 4+1 vende** dhe me cilindratë jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërrim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, personat me aftësi të kufizuara që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përrkatëse, dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale e jo për veprimtari private;

d) makinat bujqësore.

(Shtuar me Ligj Nr.86/2019, datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren zyrtare nr.184, datë 31.12.2019)

1/1. Falen të gjitha detyrimet e prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor për mjetet e sekuestruara apo të konfiskuara me vendim të formës së prerë të gjykatës, të cilat i kalojnë në administrim Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ose Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit për qëllime përdorimi apo rishitjeje.

**2. Pika 2 shfuqizohet me Ligj Nr.157/2014, datë 27.11.2014.**

3. Përfshihen nga pagimi i taksës së akteve dhe të pullës:

a) veprimet zyrtare, që kërkohen nga autoritetet e huaja, në bazë reciprociteti;

b) regjistrimi i lindjeve dhe i vdekjeve, si dhe shënimet në regjistrat e gjendjes civile.

4. Përfshihen nga pagimi i taksës së materialeve/artikujve plastikë dhe ambalazheve prej plastike/qelqi, sipas nenit 4:

a) importimi për nevoja zyrtare dhe personale, në kuadër të misioneve diplomatike dhe konsullore, përfshirë edhe konsujt e nderit, si dhe misionet speciale të akredituara në Shqipëri;

b) importimi për nevoja zyrtare dhe personale të organizmave ndërkombëtarë, të njohur si të tillë nga Republika e Shqipërisë e sipas limiteve dhe kushteve të përcaktuara në konventat ndërkombëtare, në bazë të të cilave janë formuar këta organizma ose në marrëveshjet reciproke;

c) importimi produkteve për qëllime të ndihmave humanitare;

ç) ambalazhet plastike të importuara veçmas apo kur ambalazhojnë artikuj të tjerë të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave si më poshtë:

i) arkat plastike;

ii) fuçitë me kapacitet  $\geq 20$  litra;

iii) kapakët e CD-ve dhe DVD-ve;

iv) kutitë paketuese dhe tasat për ushqime;

v) kutitë e votimit;

vi) mbajtëset për kafe, çaj, erëza;

vii) mbajtëset për ushqimet, si: marmelatë, bukë, salcë, fruta, gjalpë, vaj etj.;

viii) paketuesit për serumet, gjakun dhe barnat mjekësore;

d) ambalazhe qelqi, të importuara veçmas apo kur ambalazhojnë artikuj të tjerë të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave si më poshtë:

i) ampulat për barnat mjekësore;

ii) shishet për mbajtjen e serumit, gjakut dhe barnave mjekësore;

dh) ambalazhet plastike dhe qelqi, të vendosura nën regjime doganore pezulluese.

dh) lëndët e para në forma primare apo artikujt e tjerë të importuar dhe që klasifikohen në kapitullin 39, të NKM-së, të cilat përdoren si plotësues teknologjik, lëndë të para aditive (agregate lidhëse), apo si material për prodhimin e produkteve që nuk kategorizohen si artikuj plastikë. Taksa për lëndët e para në forma primare apo artikujt e tjerë të importuar do të aplikohet vetëm nëse materialet/artikujt e prodhuar nga këto lëndë të para janë subjekt i llogaritjes së taksës në rast se këto materiale/artikuj do të importohen;

e) lëndët e para në forma primare për prodhimin e polisterolit (EPS expanded polystyrene), importimi i paneleve, pllakave të polistirenit (XPS extruder polystyrene), si dhe profileve PVC për prodhimin e dymave dhe dritareve, sipas kapitullit 39, të NKM-së, artikujt të cilët përdoren në industrinë e ndërtimit në funksion të eficiencës së energjisë;

ë) lëndët e para në forma primare për prodhimin e sfungjerëve, si dhe importimi i materialeve/artikujve, sipas kapitullit 39, të NKM-së, që përdoren në industrinë e prodhimit të mobilieve;

f) lëndët e para në forma primare me përmbajtje proteinike të forta apo materialet celulozike, sipas kapitullit 39, të NKM-së, të cilat përdoren në industrinë e prodhimit të sallameve. Kodet e detajuara të artikujve në kapitullin 39, të NKM-së, që përjashtohen nga taksa, sipas pikave “dh”, “e”, “ë” dhe “f” më sipër, përcaktohen në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

(Shtuar me Ligj Nr.55/2019 datë 18.07.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 113, datë 01.08.2019)

5. Taksa mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror nuk zbatohet mbi trojet turistike, mbi objektet dhe trojet e pranuar në proces legalizimi apo mbi trojet shtetërore, të dhëna me qëllim investimin mbi to, të cilat rregullohen nga ligje të tjera. Përjashtohen nga pagesa e vlerës së qirasë së truallit në përdorim, nga momenti i privatizimit, blerjes apo ndërtimit të objekteve deri në datën 7.6.2010, të gjitha subjektet apo individët që janë objekt i ligjit nr. 10 270, datë 22.4.2010, “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën e përdorimit të tij”, të ndryshuar, të cilët bëjnë kërkesë për privatizimin e këtij trualli dhe paguajnë në mënyrë të menjëhershme vlerën e plotë të tij.

**6. Përjashtohen nga pagimi i taksës së qarkullimit dhe taksës së karbonit anijet e peshkimit. Sasitë, kushtet dhe kriteret përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave brenda datës 15 janar 2015.**

7. Përjashtohen nga pagimi i taksës së përvitshme dhe të regjistrimit të mjeteve luksoze:

a) mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, që gëzojnë status diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit;

b) personat fizikë apo juridikë, të cilët deklarojnë se nuk do të qarkullojnë me mjete në pronësi të tyre gjatë vitit kalendarik, përkohësisht vetëm një herë brenda një viti kalendarik, ose do të dalin përfundimisht nga qarkullimi dhe që dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor targën dhe lejen e qarkullimit, me kusht që të kenë paguar detyrime të prapambetura, nëse kanë;

**c) pagesat e taksës së mjeteve të bllokuara me vendim të gjykatës, të prokurorisë, për periudhën në të cilën mjeti ka qenë i bllokuar, dhe pagesat e taksës së mjeteve të vjedhura, të djegur, të shkatërruara nga aksidentet, të vërtetuara nga organet e prokurorisë.**

ç) të gjitha detyrimet e prapambetura të taksës së përvitshme dhe të regjistrimit të mjeteve luksoze të sekuestruara apo të konfiskuara me vendim të formës së prerë të gjykatës, të cilat i kalojnë në administrim Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ose Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit për qëllime përdorimi apo rishitjeje.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 120/2013, date 18.04.2013. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 67, date 3.05.2013).

(Ndryshuar me Ligj Nr. 178/2013, dt 28.12.2013. Botuar ne Fl.Z. Nr. 203, dt. 30.12.2013.)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 86/2014, date 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014)

**(Ndryshuar me Ligj Nr. 157/2014, datë 27.11.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 195, datë 24 dhjetor 2014.)**

(Ndryshuar me Ligj Nr.141/2015, datë 17.12.2015. Botuar në Fletoren zyrtare nr.252, datë 22.01.2016.)

**(Ndryshuar me Ligj Nr.127/2016, date 15.12.2016. Botuar në Fletoren zyrtare nr. 250 datë 27.12.2016)**

**(Ndryshuar me Ligj Nr.93/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 28.12.2018)**

### **Neni 10**

#### **Shkeljet dhe sanksionet**

1.Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, që përbëjnë kundërvajtje administrative, përcaktohen sipas ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen po sipas ligjit të procedurave tatimore në Republikën e Shqipërisë.

2.Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masave administrative bëhen në përputhje me ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 11**

#### **Tarifa shërbimi**

1. Përveç tarifave të shërbimit, të përcaktuara në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, quhen tarifa shërbimi edhe:

a) tarifa e pajisjes me leje drejtimi e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;

b) tarifa për përdorimin e aparateve televizive e Radiotelevizionit Publik Shqiptar;

c) **tarifë shërbimi konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme apo ambasadave tona jashtë vendit;**

ç) tarifa për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë dhe noterisë.

**(Ndryshuar me Ligj Nr. 178/2013, dt 28.12.2013. Botuar ne Fl.Z. Nr. 203, dt. 30.12.2013.)**

d) tarifa për shërbimet e transmetimeve radiotevizive e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT);

dh) tarifa për pajisjen me pasaportë lundrimi e kapitenerisë së porteve;

e) tarifa për shërbimet e radiokomunikimit e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP);

ë) **tarifa e shërbimit për qarkullimin e mjeteve të huaja të transportit të udhëtarëve të më shumë se 20 personave, përfshirë edhe drejtuesin e mjetit, si dhe të mjeteve të transportit të mallrave me ngarkesë apo pa ngarkesë përcaktohet me reciprocitet.**

f) tarifa për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë.

2. Të gjitha detyrimet e prapambetura të tarifës së shërbimit për qarkullimin e automjeteve të huaja falen. Procedurat e faljes së tarifës së shërbimit për qarkullimin e automjeteve të huaja caktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

**2. Nivelet minimale të tarifave të shërbimit, të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe agjentët tatimorë e komisionet përkatëse të tyre përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të titullarëve të institucioneve përkatëse.”**

### **Neni 11/1**

#### **Përjashtimet nga pagesa e tarifave të shërbimit**

1. Personat që gëzojnë statusin e invalidit, në bazë të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, statusin e invalidit të luftës, në bazë të ligjit nr. 7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, statusin e veteranit të luftës, në bazë të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të ndryshuar, apo statusin e të verbrit, në bazë të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, përjashtohen nga: a) tarifa për shërbimet konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme apo e ambasadave tona jashtë vendit; b) tarifa për përdorimin e aparateve televizive e Radiotelevizionit Publik; c) tarifa për pajisjen me pasaportë lundrimi e Kapitenerisë së Porteve;

ç) tarifa për veprime e shërbime të administratës së Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë dhe noterisë;

2. Personat e sipërpërmendur nuk i përfitojnë këto përjashtime nëse kryejnë veprimtari private si persona fizikë apo juridikë.  
(Ndryshuar me Ligj Nr.104/2017, datë 30.11.2017. Botuar në Fletoren zyrtare nr.222, datë 19.12.2017)

### **Neni 11/2** **Deklarata për pagesën e tarifave kombëtare**

1. Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të pagesës së tarifave kombëtare, në përputhje me nenin 11, të këtij ligji, si dhe agjentët e tarifave kombëtare, në rastin kur tarifat mbliidhen me agjentë, detyrohen:

a) të bëjnë një deklaratë për çdo muaj, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklaratimet;

b) të paguajnë tarifën kombëtare për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës.

2. Deklarata, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, bëhet në formën dhe përmbajtjen që përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. Deklarata për pagesën e tarifës kombëtare dorëzohet në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pranë drejtorisë rajonale tatimore ku është i regjistruar personi fizik/personi juridik, subjekt i deklaratimit të tarifës kombëtare. (Ndryshuar me Ligj Nr. 86/2014, date 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014)

### **Neni 12** **Shfuqizimet**

Ligji nr.8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, shfuqizohet.

### **Neni 13**

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

### **Neni 14**

### Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky ligj hyn në fuqi më 1 tetor 2012.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Miratuar në datën 18.4.2013

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2014. Miratuar në datën 28.12.2013

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Miratuar në datën 17.7.2014

**Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në 1 janar 2015.**

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare nga data 1 janar 2017.

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në datën 1 janar 2016.

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2018, me përjashtim të nenit 2, që hyn në fuqi më 1 qershor 2018.

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

### Dispozita kalimtare

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjithë pronarët e mjeteve, që nuk kanë paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura, paguajnë sipas këtij ligji. Në rast se pagesa bëhet brenda datës 30 qershor 2013, ata përjashtohen edhe nga penalitetet për vonesë në pagesën e taksave. Aplikimi i penalitetit për vonesë në pagesën e taksave, për të gjitha mjetet, që u ka kaluar afati i vlefshmërisë së taksave, pavarësisht kur e kanë kryer pagesën e taksave, fillon nga data 1 janar 2014.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 120/2013, date 18.04.2013. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 67, date 3.05.2013).

Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji. (Ndryshuar me Ligj Nr. 86/2014, date 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014.)

**Ndryshuar me Ligj Nr.10 065, datë 29.1.2009, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 9 datë 09.02.2009. Ndryshuar me Ligj Nr. 10 131 dt. 11.5.2009, Fletorja Zyrtare nr. 86. Dt. 12.6.2009**

**Ndryshuar me Ligj nr. 10145, date 28.9.2009, te botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 144 dt. 12 tetor 2009.**

**Ndryshuar me Ligjin nr.10280, dt.20.5.2010, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 73, dt. 29.06.2010.**

**Ndryshuar me Ligj Nr. 10458, date 21.7.2011. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 107, date 9.08.2011.**

**Ndryshuar me Ligj Nr. 83/2012, date 13.9.2012. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 127, date 1.10.2012.**

**Ndryshuar me Ligj Nr. 120/2013, date 18.04.2013. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 67, date 3.05.2013.**

**Ndryshuar me Ligj Nr. 178/2013, date 28.12.2013. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203, date 30.12.2013.**

**Ndryshuar me Ligj Nr. 86/2014, date 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014.**

**Ndryshuar me Ligj Nr. 157/2014, date 27.11.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 195, datë 24.12.2014.**

**Ndryshuar me Ligj Nr.127/2016, datë 15.12.2016. Botuar në Fletoren zyrtare nr.250 date 27.12.2016**

**Ndryshuar me Ligj Nr.141/2015, datë 17.12.2015. Botuar në Fletoren zyrtare nr.252, datë 22.01.2016.**

**Ndryshuar me Ligj Nr. 68/2017, date 27.04.2017. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 113, date 22.05.2017**

**Ndryshuar me Ligj Nr.104/2017, datë 30.11.2017. Botuar në Fletoren zyrtare nr.222, datë 19.12.2017.**

**Ndryshuar me Ligj Nr.93/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 28.12.2018**

**Ndryshuar me Ligj Nr.55/2019. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 113, datë 01.08.2019**

**Ndryshuar me Ligj Nr. 86/2019, datë 18.12.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184, datë 31.12.2019**

**Ndryshuar me Ligj Nr. 153 / 2020, date 17.12.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 8, datë 18.01.2021**

**Ndryshuar me Ligj Nr. 151 / 2020, datë 17.12.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 27, datë 19.02.2021**

## **Shtojca Nr.1**

### **KOEFIÇIENTËT SIPAS VJETËRSISË PËR TAKSËN VJETORE TË MJETE TË PËRDORURA**

<b>Motomjete, autovetura, automjete per transport te perzier</b>		<b>Të gjitha llojet e tjera</b>		<b>Autobusët</b>	
<b>Mosha e mjetit</b>	<b>Koeficienti i viteve të përdorimit</b>	<b>Mosha e mjetit</b>	<b>Koeficienti i viteve të përdorimit</b>	<b>Mosha e mjetit</b>	<b>Koeficienti i viteve të përdorimit</b>
<b>1</b>	<b>0,00</b>	<b>1</b>	<b>0,00</b>	<b>1</b>	<b>0,00</b>
<b>2</b>	<b>0,00</b>	<b>2</b>	<b>0,00</b>	<b>2</b>	<b>0,00</b>
<b>3</b>	<b>0,00</b>	<b>3</b>	<b>0,00</b>	<b>3</b>	<b>0,00</b>
<b>4</b>	<b>0,18</b>	<b>4</b>	<b>0,20</b>	<b>4</b>	<b>0,07</b>
<b>5</b>	<b>0,19</b>	<b>5</b>	<b>0,22</b>	<b>5</b>	<b>0,08</b>
<b>6</b>	<b>0,20</b>	<b>6</b>	<b>0,24</b>	<b>6</b>	<b>0,09</b>
<b>7</b>	<b>0,21</b>	<b>7</b>	<b>0,26</b>	<b>7</b>	<b>0,10</b>
<b>8</b>	<b>0,22</b>	<b>8</b>	<b>0,28</b>	<b>8</b>	<b>0,11</b>
<b>9</b>	<b>0,23</b>	<b>9</b>	<b>0,30</b>	<b>9</b>	<b>0,12</b>
<b>10</b>	<b>0,24</b>	<b>10</b>	<b>0,32</b>	<b>10</b>	<b>0,13</b>
<b>11</b>	<b>0,28</b>	<b>11</b>	<b>0,34</b>	<b>11</b>	<b>0,14</b>
<b>12</b>	<b>0,32</b>	<b>12</b>	<b>0,36</b>	<b>12</b>	<b>0,15</b>
<b>13</b>	<b>0,36</b>	<b>13</b>	<b>0,38</b>	<b>13</b>	<b>0,16</b>



14	0,40	14	0,40	14	0,17
15	0,44	15	0,42	15	0,20
16	0,48	16	0,44	16	0,23
17	0,52	17	0,46	17	0,26
18	0,56	18	0,48	18	0,29
19	0,60	19	0,50	19	0,32
20	0,64	20	0,52	20	0,35
21	0,68	21	0,54	21	0,38
22	0,70	22	0,56	22	0,40
23	0,72	23	0,58	23	0,42
24	0,74	24	0,60	24	0,44

**Shënim:** Pas vitit të 24-t të përdorimit, për autobusët koeficienti rritet me 0,03 dhe për të gjitha mjetet e tjera rritet me 0,0, ndërsa për motomjetet, autoveturat, automjetet për transport të përzier rritet me 0,04.

**SHTOJCA NR. 2**  
**RENTA MINERARE SIPAS KLASIFIKIMIT**

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi i grupit të mineraleve sipas ligjit</b>	<b>Përqindja e rentës</b>
------------	---	---------------------------

		<b>minerare</b>
<b>Grupi i parë (I) MINERALET METALIKE</b>		
<b>1</b>	<b>Mineralet e Argjendit</b>	<b>10 %</b>
<b>2</b>	<b>Mineralet e Arit</b>	<b>10 %</b>
<b>3</b>	<b>Mineralet e Bakrit</b>	<b>6 %</b>
<b>4</b>	<b>Mineralet e Kromit për eksport</b>	<b>7 % duke filluar nga data 1 janar 2019, 8 % duke filluar nga data 1 janar 2020 dhe 9 % duke filluar nga data 1 janar 2021 dhe në vijim.</b>
<b>5</b>	<b>Mineralet e Nikelit (nikel-silikat)</b>	<b>6 %</b>
<b>6</b>	<b>Mineralet e Hekurit (hekur-nikeli)</b>	<b>5 %</b>
<b>7</b>	<b>Mineralet Plumbit</b>	<b>5 %</b>
<b>8</b>	<b>Mineralet e Zinkut</b>	<b>7 %</b>
<b>9</b>	<b>Gjithë mineralet e tjera metalike</b>	<b>4 %</b>
<b>Grupi i dytë (II) MINERALET JOMETALIKE</b>		
<b>10</b>	<b>Të gjitha mineralet jometalike</b>	
<b>Grupi i tretë (III) QYMYRET DHE BITUMET</b>		
<b>11</b>	<b>Qymyret</b>	<b>19 940 lekë/ton</b>
<b>12</b>	<b>Bitumet</b>	<b>2 371 lekë/ton</b>
<b>13</b>	<b>Rërat bituminoze</b>	<b>117 lekë/m<sup>3</sup></b>

14	<b>Reshpet naftore</b>	117 lekë/m <sup>3</sup>
15	<b>Pirobitumet</b>	186 lekë/ton
16	<b>Qymyr guri</b>	200 lekë/ton
<b>Grupi i katërt (IV) MINERALET DHE MATERIALET E NDERTIMIT</b>		
17	<b>Graniti</b>	850 lekë/m <sup>3</sup>
18	<b>Gëlqerorët</b>	47 lekë/m <sup>3</sup>
19	<b>Gabrot</b>	47 lekë/m <sup>3</sup>
20	<b>Bazaltet</b>	73 lekë/ton
21	<b>Konglomerate</b>	7 %
22	<b>Mermeri</b>	4 095 lekë/m <sup>3</sup>
23	<b>Pllakat e ndërtimit</b>	
23.1	<i>Pllaka guri</i>	228 lekë/m <sup>3</sup>
23.2	<i>Pllaka ranore</i>	1 456 lekë/m <sup>3</sup>
23.3	<i>Pllaka graniti</i>	6 825 lekë/m <sup>3</sup>
23.4	<i>Pllaka mermeri</i>	4 550 lekë/m <sup>3</sup>
23.5	<i>Pllaka të tjera</i>	6 000 lekë/ton
24	<b>Pllagjiogranitet</b>	5 %
25	<b>Ranoret</b>	491 lekë/m <sup>3</sup>
26	<b>Serpentinit et</b>	47 lekë/m <sup>3</sup>
27	<b>Travertinat</b>	2 925 lekë/m <sup>3</sup>
28	<b>Traktolitet</b>	2 925 lekë/m <sup>3</sup>
29	<b>Gips</b>	21 lekë /ton
30	<b>Alabastër</b>	423 lekë/m <sup>3</sup>
31	<b>Argjila (prodhim çimento,</b>	15 lekë/ton

	tjegulla, tulla etj.)	
32	Argjila (prodhim dige hidrocentrale)	104 lekë/m <sup>3</sup>
33	Argjil (për prodhim qeramike)	23 lekë/ton
34	Rërë lumi	98 lekë/m <sup>3</sup>
35	Inerte lumore	42 lekë/m <sup>3</sup>
36	Gjithë mineralet e tjera të grupit të katërt	104 lekë/m <sup>3</sup>
<b>Grupi i pestë (V) GURËT E ÇMUAR</b>		
37	Gjithë mineralet e grupit të	
<b>Grupi i gjashtë (VI) GURËT GJYSME TE ÇMUAR DHE OPALI</b>		
38	Gjithë mineralet e grupit të gjashtë	10 %

Ndryshuar me Ligj Nr.93/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 28.12.2018

Shfuqizuar grupi i shtatë me Ligj Nr. 153 / 2020, date 17.12.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 8, datë 18.01.2021

**SHTOJCA NR. 3  
TAKSA E AKTEVE DHE E PULLËS**

**MASA E TAKSËS**

1.Për lëshimin e certifikatave për përdorim brenda vendit  
2.Për lëshimin e certifikatave për përdorim nga autoritetet e huaja  
Adresa: Rruga Gjini Bue Shpata

50 lekë  
200 lekë  
www.tatime.gov.al

3.Për regjistrimin e shtetasve të huaj pas dhënies së shtetësisë shqiptare	2 000 lekë
4.Për procedurën e ndryshimit të emrit/mbiemrit	1 000 lekë
5.Për mbajtjen e akteve të lidhjes së martesës	1 000 lekë
6.Për procedurën për veçim/bashkim familjeje	1 000 lekë

SHTOJCA NR.4  
TAKSA VJETORE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË  
PESHKIMIT

Lekë në vit

I. Peshkimi detar (për 1 anije)

1. Peshkimi detar fundor:

- anije 160-200 HP	40 000
- anije 201-410 HP	50 000
- mbi 410 HP	80 000

3. Peshkimi pellagjik me tratavolante:

- anije 160-200 HP	20 000
- anije 201-410 HP	30 000
- anije mbi 410 HP	40 000

3. Peshkimi pellagjik me rrethime:

- anije 80-200 HP	10 000
- anije 201-410 HP	20 000
- anije mbi 410 HP	30 000

4. Peshkimi pellagjik dhe fundor:

- anije 160-200 HP	40 000
- anije 201-410 HP	60 000
- anije mbi 410 HP	90 000

5. Peshkimi me mjete selektike:

- anije 40 - 80 HP	15	000
- anije 81-160 HP	25	000
- anije 161-200 HP	40	000
- anije 201-410 HP	50	000
- anije mbi 410 HP	80 000	

6. Peshkimi i molusqeve bivalvore  
(i autorizuar) 60 000

II. Peshkimi artizanal me mjete të lehta:

1. Peshkimi në bregdet (për një sanall dhe me motor  
deri në 40HP)

7 000

2. Peshkimi në lagunat bregdetare:

- në lagunë (1 lundror)	10 000
- në dajlane (1 peshkatar)	12 000
3. Peshkimi në ujëra të brendshme:	
- aktiv (1 lundror)	5 000
- në dajlane e prita (1 peshkatar)	8 000
4. Grumbullimi i molusqeve bivalvore me mjete të lehta (gabie) për 1(një) peshkatar	20 000
III. Peshkimi sportiv në det me mjete lundruese (për 1 mjet)	40 000
IV. Akuakultura:	
1. Kultivimi i midhjeve për një impiant	10 000
2. Kultivimi i peshqve me impiante në det, në liqene, në rezervuarë	1 000
3. Akuakulturë me impiante në tokë	10 000

Shënim: Për anijet e huaja që marrin licencë peshkimi në ujërat tona territoriale, taksa e lejes së ushtrimit të veprimtarisë është sa dyfishi i anijeve shqiptare. Nuk i nënshtrohen kësaj takse anijet e autorizuara nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (Drejtoria e Politikave të Peshkimit), që do të peshkojnë për qëllime studimore e shkencore.